

STRESI PRINDËROR DHE REZILIENCA TEK PRINDËRIT E FËMIJËVE ME
VËSHTIRËSI NEUROZHVILLIMORE

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË FUSHËN
PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

nga

Naile Rustolli



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
PSIKOLOGJI
PRISHTINË

MAJ, 2022

Stresi Prindëror dhe Rezilienca tek Prindërit e Fëmijëve me Vështirësi Neurozhvillimore

Kandidatja: Naile Rrustolli

Mentore: Prof. Ass. Dr. Kaltrina Kelmendi

Sfidat me të cilat përballen prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore të shoqëruara me emocione negative dhe frikë për të ardhmen e fëmijës së tyre kanë ndikime negative dhe afatgjata në mirëqenien e tyre psikologjike. Të kuptuarit e faktorëve që lehtësojnë tejkalimin e situatave stresuese tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore do të ketë ndikime pozitive në prindërimin e tyre efektiv duke rritur cilësinë e madhënies prind fëmijë dhe gjendjen emocionale duke i bërë të ndihen se mund t'i plotësojnë kërkesat e fëmijës së tyre. Qëllimi i këtij studimi ishte që të analizoj ndërlidhjen ndërmjet Stresit Prindëror dhe Reziliencës tek Prindërit e Fëmijëve me Vështirësi Neurozhvillimore. Po ashtu studimi ka synuar të nxjerr në pah dallimet gjinore në nivelin e përjetimit të stresit tek prindërit e këtyre fëmijëve. Qëllim tretësor i punimit ishte që të analizohet nëse ekzistojne dallime ndërmjet stresit që përjetojnë prindërit e fëmijëve me autizëm krahasuar me prindërit e fëmijëve tjerë me vështirësi neurozhvillimore. Duke pasur parasysh të kuptuarit e faktorëve që rrisin nivelin e përjetimit të stresit tek prindërit që kanë fëmijë me vështirësi neurozhvillimore është primare, me qëllim të realizimit të ndërhyrjeve dhe përkrahjeve efikase në mënyrë që të jenë më lehtë të përballueshme për këta prind. Punimi aktual është përmbledhur në 71 faqe dhe është stukturuar në 5 kapituj.

Kapitulli i I-rë paraqet pjesën hyrëse të punimit, ku specifikohet rëndësia e temës aktuale dhe qëllimi i realizimit të këtij studimi. Pjesë e këtij kapitulli janë shpjeguar edhe kornizat teorike në të cilat është bazuar studimi.

Kapitulli i II-të është realizuar shqyrtimi i literaturës me të gjeturat e realizuara në vende të ndryshme të botës rreth stresit prindëror dhe reziliencës tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore. Në këtë kapitull poashtu është realizuar përkufizimi i termave kryesorë dhe janë paraqitur pyetjet dhe hipotezat e studimit aktual të cilat ishin:

1. Cilat janë dallimet gjinore në nivelin e përjetimit të stresit tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore?
2. Cilat janë dallimet në nivelin e përjetimit të stresit prindëror ndërmjet prindërve të fëmijëve me autizëm dhe atyre me crregullime të tjera neurozhvillimore?

3. Cili është roli i reziliencës në tejkalimin të situatave stresuese tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore?

H1: Nënata e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore raportojnë nivel më të lartë të stresit prindëror krahas baballarëve.

H2: Baballarët e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore raportojnë nivel më të vogël të stresit prindëror.

H3: Prindërit e fëmijëve me autizëm do të përjetojnë nivele më të larta të stresit prindëror.

H4: Rezilienca ka ndikim pozitiv në tejkalimin e situatave stresuese tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore.

Kapitulli i III-të paraqet pjesën e metodologjisë ku përfshihen dizajni i studimit, pjesëmarrësit, matjet, procedura, etika dhe analiza e të dhënave. Për realizimin e studimit është përdorur dizajni kuantitativ dhe pjesë e studimit kanë qenë $n=32$ prind të fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore, $n=16$ nena dhe $n=16$ baballarë. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësorët Parenting Stress Index PSI (Abidin, 1995) dhe Resilience Profolio Questionnaire (Hamby, Taylor, Smith, & Blount, 2018).

Kapitulli i IV-të përshkruan pjesën e rezultateteve të studimit aktual të cilat janë paraqitur në formë të tabelave dhe grafikoneve. Fillimisht është paraqitur analiza deskriptive e pyetjeve demografike dhe e variablave si stresi prindëror, rezilienca; fuqitë rregullative, fuqitë e kuptim dhënies, fuqitë ndërpersonale dhe mirëqenia subjektive. Rezultatet treguan që nuk ka dallime gjinore në nivelin e përjetimit të stresit prindëror tek prindërit e fëmijëve me vështirësi neurozhvillimore, në bazë të mesatareve të nivelit të pikëve për çdo testim, dhe nivelit të signifkancës, rezultatet treguan se nuk ka dallime signifkante në asnjë variabël në mes dy grupeve të ndryshme gjinore. Kanë dallime në mesatare, por jo aq të mëdha sa të jenë statistikisht të vlefshme për tu marrë parasysh., poashtu prindërit e fëmijëve me autizëm nuk raportuan nivel më të lartë të stresit prindëror krahas prindërve të tjerë me fëmijë me vështirësi neurozhvillimore, Në bazë të nivelit të mesatarës rezultatet treguan se nivel më të lartë të stresit prindëror kanë prindërit e fëmijëve që kanë diagnozë aktuale të vonesës në zhvillim me vlerë të mesatarës 153.75, pastaj diagnoza e sindromës doën me vlerë të mesatares 138.40, me diagnozë të autizmit 137.83, me diagnozë të ADHD 105.75 dhe me diagnozë të implantit koklear me vlerë të mesatares 104.50. Poashtu, rezultatet treguan rëndësinë e reziliencës (fuqive rregullative, fuqive ndërpersonale dhe fuqive të kuptim dhënies) duke raportuar impaktin që ka në stresin prindëror, me rritjen e

reziliencës ulet stresi prindëror, variabla e Mirëqenies Subjektive ndikohet në 67% të variancës nga variablat e pavarura që masin nivelin e fuqive ndërpersonale, të kuptimdhënies dhe asaj rregullative. Poashtu, rezultatet tregojnë se modeli është me vlerë të lartë të signifkancës $p=.001$ dhe me nivel të betas β -betas me vlerë $\beta=.130$ për fuqitë rregullative, $\beta=.045$ për variablën e fuqive të kuptimdhënies dhe me nivel mbi mesatare të $\beta=.552$.

Kapitulli i V-të përfshin pjesën e diskutimit ku bëhet krahasimi i rezultateve të këtij studimi me studimet e kaluara dhe raportohet konfirmimi i hipotezës së tretë dhe mos konfirmimi i hipotezës së parë dhe të dytë. Në këtë pjesë poashtu përshkruhen limitimet dhe rekomandimet për studimet e ardhshme.